



DEPARTIMI I KËSHILLIT TË PROKURORËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE
KËSHILLI I PROKURORIALIT TË KOSOVËS - TUZILAÇKI SAVETI TË KOSOVËS
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA

Pranuar **01-11-2022** Primitjeto

Numri render Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nënshkrimi i prarësuarit Potpis primaoca
1815		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

MEKANIZMI I RAPORTIMIT
TË KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE THEMELORE
NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

A.nr. 224/22

I. PJESA E PËRGJITHSHME:

Agim Kurmehaj	Prokuroria Themelore – Pejë	Korrik – Shtator 2022							
<i>Emri, mbiemri Kryeprokurorit</i>	<i>Prokuroria</i>	<i>Periudha raportimit</i>	<i>Nënshkrimi</i>						
Numri i prokurorëve dhe stafit administrativ në prokurori:	Kryeprokurori:	1	Administratori:	1					
	Nr. i prokurorëve në DKR:	5	Bashkëpunëtorë profesional:	8					
	Nr. i prokurorëve në DM:	2	Zyrtar ligjor:	11					
	Nr. i prokurorëve në DP:	7	Stafi tjetër:	28					
	Totali:	15	Totali:	48					
A) Numri i kallëzimeve penale të pranuar: 849	B) Numri i kallëzimeve penale të proceduara (zgjidhura/kryera): 685	C) Përqindja e rasteve të proceduara (B%A)	D) Ngarkesa me lëndë						
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga prokurori:	Aktakuza të ngritura: 486	Hudhje të kallëzimit penal: 135	Pushim i hetimeve: 50	Mënyrë tjetër: 14					
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata:	Aktakuza të hudhura: 59	Aktakuza të refuzuara: 20	Aktgjykime liruese: 19	Aktgjykimi dënues: 321					
Ankesa kundër aktgjykimit		Ankesa kundër aktvendimit							
Të aprovuara 3	Të refuzuara	Të aprovuara	Të refuzuara						
Arritshmëria e normës orientuese të prokurorëve, për periudhën kohore të raportimit:									
Departamenti për Krime të Rënda:	79	110%	6 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,						
Departamenti për të Mitur:	61	102%	10 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,						
Departamenti i Përgjithshëm:	545	132%	23 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,						
Arritshmëria e normës në Prokurori:	685	125%	Mesatarja (3/1) e përqindjet në prokurori						
Performanca e prokurorisë në luftimin e Korrupsionit (Paditë Penale 'PP'). Shihet të dhënat në tabelë:									
Raste të pranuar:	Raste të kryera:	Ngarkesa me raste:	Hudhje	Pushim	Janë ngritur Aktakuza	Aktakuza hudhura	Aktakuza të refuzuara	Aktgjyqi me liruese	Aktgjykimi dënues
R ¹	P ²	R	P	R	P	Persona	Persona	Persona	Persona
14	19	12	22	4	4	1	2	3	3

¹ 'R' - nënkupton rastet (kallëzimet penale)

² 'P' - nënkupton personat në kallëzime penale

Performanca në sekustrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Shëno të dhënat në tabelë:				
Kërkesa të aprovuara për dhënie e urdhrat për sekuestrim të përkohshëm	Kërkesa të aprovuara për konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve financiare	Kërkesa të aprovuara për dhënie e aseteve në shfrytëzim të qeverisë	Kërkesa të aprovuara për dhënie e aseteve në administrim të AAPSK	Kërkesa për kompensimin e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara
39	4		5	

II. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

1	<p>Niveli i organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë?</p> <p>Komento:</p> <p>Lidhur me nivelin e organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë, mendoj se këtu qëndrojmë shumë mirë, madje shquhemi në këtë drejtim. Të gjitha këto janë të bazuara në Planin për menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Pejë, i cili është i harmonizuar me planet dhe strategjitë e KPK-së dhe ZKPSH-së. Sidoqoftë me lëvizjet e fundit që janë bërë, përkatësisht transferet, mbetet shqetësuese numri i vogël i prokurorëve në Departamentin e përgjithshëm të kësaj prokurorie.</p>
2	<p>Çështjet e avancimit dhe transferimit të prokurorëve?</p> <p>Komento:</p> <p>Sa i përket avancimit dhe transferimit të prokurorëve, për këtë periudhë një prokuror është avancuar në Departamentin e Krimeve të Rënda, gjersa edhe dy prokuror nga Departamenti i Përgjithshëm janë transferuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.</p>
3	<p>Çështjet e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve apo stafit mbështetës?</p> <p>Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 4 kërkesa në AD gjersa janë përfunduar 3 prej tyre.</p>
4	<p>Çështjet e vlerësimit të punës së prokurorëve përfshirë mospajtimet e prokurorëve?</p> <p>Nivelet e vlerësimit të prokurorëve si dhe tejkalimi kuotës 20% të dalluar?</p> <p>Komento:</p> <p>Çështja e vlerësimit të prokurorëve është përfunduar me kohë, ku janë vlerësuar të gjithë prokurorët, ndërsa për këtë periudhë kemi vazhduar monitorimin e prokurorëve në scanca dhe diskutimin gjashtëmujor.</p>
5	<p>Çështjet e rasteve të ndërlikuara dhe vendimet nga Kryeprokurori për njohjen e këtyre rasteve?</p> <p>Komento:</p> <p>Duke marrë parasysh se si Kryeprokuror, gjithnjë jam në rrjedha të lëndëve të kësaj prokurorie, gjatë kësaj periudhe nuk kam pas raste të tilla.</p>
6	<p>Ankesat ndaj shqiptimit të sanksionit penal të shqiptuar (<i>Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit</i>)?</p> <p>Komento:</p> <p>Kryeprokurori gjithmonë është në dijeni për aktgjykimet e Gjykatës dhe me rastin e udhëzimit për ushtrimin e mjeteve juridik përkatësi me shqiptimin e sanksionit penal, gjithnjë prokurorët udhëzohen që të bazohen në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për politikën ndëshkimore dhe Udhëzuesin e Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit.</p>
7	<p>Zbatimi i politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit?</p> <p>Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së prokurorëve mentorë për prokurorët fillestar?</p> <p>Komento:</p> <p>Konkursin e fundit kam konsultuar si Kryeprokuror që të rekomandoj një prokuror për mentor të prokurorit fillestar dhe përzgjedhjen e kam bërë duke u bazuar në përvojën e prokurorës.</p>

8	<p>Niveli i zbatimit të Kodit të Etikës profesionale për prokurorë dhe stafin administrativ?</p> <p>Komento:</p> <p>Gjithmonë si nga prokurorët, ashtu edhe nga stafi administrativë është kërkuar respektimi i Kodit të Etikës dhe nuk kemi ndonjë rast që ndonjë prokuror ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.</p>
9	<p>Niveli i pavarësisë së prokurorëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale?</p> <p>Komento:</p> <p>Mendoj se prokurorët çdo herë veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale, ashtu që gjatë kësaj periudhe nuk kemi ndonjë rast që cenuar ky parim.</p>
10	<p>Zbatimi i politikave të KPK dhe ZKPSH, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ?</p> <p>Komento:</p> <p>Çdo herë si prokurori i përfillim politikat e KPK-së dhe ZKPSH-së, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike, duke i harmonizuar edhe planet tona me të lartcekurit. Me qëllim të luftimit sa më efikas të kriminalitetit dhe realizimit të planeve vjetore, kemi caktuar edhe prokuror koordinator për vepra të caktuara penale. Në disa raste është planifikuar edhe aplikimi i Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Lidhur me aplikimin e LKZK-së përpos rastit të Majit 2022, jemi në vlerësimin edhe të dy rasteve tjera.</p> <p>Lëndët për veprat penale karakteristike janë trajtuar me prioritet si në vijim:</p> <p><u>Regjistri KORR:</u> Nga ky regjistër kemi pranuar 14 raste kundër 19 personave, gjersa i kemi përfunduar 12 lëndë kundër 22 personave, ku janë ngritur 7 aktakuza kundër 16 personave, 1 rast kundër 2 persona janë pushuar hetimet dhe 4 raste kundër 4 personave janë hedhur kallëzimet penale.</p> <p><u>Regjistri E:</u> Nga ky regjistër kemi pranuar 18 raste kundër 35 personave, ndërsa janë përfunduar 4 lëndë kundër 4 personave, prej të cilave janë 3 aktakuza kundër 43 personave dhe 1 rast kundër 1 personi është pushuar hetimi.</p> <p><u>Regjistri DR:</u> Nga ky regjistër janë pranuar 36 lëndë kundër 57 personave, ndërsa janë përfunduar 37 lëndë kundër 46 personave, prej të cilave janë ngritur 33 aktakuza kundër 41 personave, 2 raste kundër 2 personave janë hedhur kallëzime penale dhe 2 raste kundër 3 personave janë dërguar në kompetencë.</p> <p><u>Regjistri TNI:</u> Nga ky regjistër kemi pranuar 2 raste kundër 3 personave, ndërsa janë përfunduar 3 raste kundër 5 personave, prej të cilave janë ngritur 2 aktakuza kundër 3 personave dhe 1 rast kundër 2 personave është pushuar hetimit.</p> <p>Nga vepra penale e dhunimit kemi pranuar 4 raste kundër 6 personave të cilat janë procedurë e sipër, gjersa nga vepra penale e sulmit seksual kemi pranuar 1 rast kundër 1 personi i cili po ashtu është në procedurë e sipër.</p> <p><u>Dhuna në familje:</u> Edhe rastet e dhunës në familje janë trajtuar me prioritet ku gjatë kësaj periudhe i kemi pranuar 110 lëndë, ndërsa janë përfunduar 95 raste të kësaj natyre. Nga lëndët e përfunduara janë ngritur 83 aktakuza, janë parashtruar 5 propozime për shqiptimin e masave, në 3 raste janë pushuar hetimet dhe në 2 raste janë hedhur kallëzimet penale.</p>

11	Niveli i zbatimit të kërkesave nga Komisionet e Përhershme të Këshillit dhe nga vet KPK-ja? Komento: Kërkesat e Komisioneve të përhershme të Këshillit dhe vetë KPK-së, trajtohen në mënyrën e duhur dhe kohë optimale.
12	Performanca e prokurorëve në përdorimin e sistemit SMIL ? Komento: Pas konsultimit me zyrtarin e IT-së dhe atë të SMIL-it, mendoj se shumica e prokurorëve kanë treguar avancim dhe performancë të mirë në përdorimin e SMIL-it.
	Sfidat apo të arriturat: Komento: Për këtë periudhë mendoj se fokusi kryesor ka qenë sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, prandaj edhe e arritur është aplikimi i LKZK-së. Sa i përket sfidave mendoj se për periudhën e ardhshme çështje problematike do të jetë numri i prokurorëve në Departamentin e Përgjithshëm.

III. ZBATIMI I OBLIGIMEVE SIPAS PLANIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË SHQETIT

1	Objekti 1: Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale me prioritet. Komento: Sa i përket efikasitetit për momentin qëndrojmë mirëpo mendoj se në departamentin e përgjithshëm numri adekuat i prokurorëve në mënyrë që të mos ngec ky parim do të ishte adekuat 13 prokuror dhe në këtë mënyrë që do të arrihej që secili rast të trajtohet me prioritet pa asnjë zvarritje, konform afateve të përcaktuara me Kodin e procedurës penale dhe KEDNJ.
2	Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit. Komento: Kjo çështje mendoj se është objektive i vazhdueshëm dhe në këtë drejtim në harmonizim të plotë me ZKPSH-në dhe KPK-në, janë lëshuar raporte 24 orësh, komunikata për rastet me interes për publikun, prokurorët kanë marrë pjesë në emisione të ndryshme të cilat kanë për qëllim rritjen e besimit të qytetarëve në organin e akuzës dhe të tjera. Duhet potencuar se vitin e kaluar kishim 59 kallëzime penale të parashtruara direkt në prokurori, gjersa vitin 2020 kishim 32, kjo tregon edhe rritjen e besimit të qytetarëve në këtë prokurori. Po ashtu edhe rastet me vetëiniciativë në vitin 2020 ishin 33 gjersa në vitin 2021 ishin 73 raste.
3	Objekti 3: Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale. Komento: Mendoj se këtu qëndrojmë mirë, ku për këtë periudhë kemi pas 39 kërkesa për sekuestrim, gjersa si konfiskim përfundimtar janë 4 të cilat janë aprovuar, ndërsa për të tjerat jemi në pritje. Po ashtu është për tu përsëritur edhe aplikimi i LKZK-së.
4	Objektivi 4: Zvogëlimi i numrit të lëndëve në Prokurorinë e Shtetit. Komento: Objektive i vazhdueshëm është ulja e numrit të lëndëve të pa kryera për këtë periudhë nuk kemi lëndë të vjetra të pa kryera mirëpo vazhdimisht kërkohet nga prokurorët që të kenë fokus edhe rritjen e efikasitetit karshi profesionalizmit.
5	Objektivi 5: Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i vazhdimsisë së punës në pandemi. Komento: Për momentin jemi duke punuar me stafe të plotë dhe varësisht prej rekomandimeve eventuale që mund të dalin në ardhmen edhe do të vlerësohet dhe analizohet planifikimi i

	vazhdimësisë së punës.
6	Objektivi 6: Administrimi efikas, llogaridhënia dhe rritja e profesionalizimit: Komente: Sikurse jeni njoftuar, në Planin për menaxhimin e prokurorisë kemi paraparë përfaqësimin e lëndëve nga ana e prokurorit i cili ka qenë bartës i asaj lënde, sepse kjo çështje do të rrisë profesionalizimin e përfaqësimit. Sidoqoftë nga ana e gjyqtarëve nuk kemi has mirëkuptim të plotë por ja kemi arritur që ta menaxhojmë këtë mënyrë të përfaqësimit ku prokurorët, lëndët që janë specifike i kanë përfaqësuar vet duke u zëvendësuar me prokuror tjerë.
7	Objektivi 7: Aplikimi më efikas i procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve penale. Komente: Sikurse vitin e kaluar, aplikimi i këtyre procedurave ka vazhduar në mënyrën e njëjtë, ku e kemi të caktuar zyrtarin i cili merret me marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë dhe zyrtari përgjegjës për procedurën e ndërmjetësimit. Gjatë kësaj periudhe 36 raste kundër 63 personave kanë përfunduar me aplikimin e këtyre procedurave.
8	Objektivi 8: Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i Prokurorit të Shtetit. Komente: Sikurse jeni në dijeni lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar është i caktuar prokurori i cili merret me trajtimin e kërkesave nga shtetet tjera dhe anasjelltas ashtu që secila kërkesë trajtohet me prioritet.

IV. KËRKESAT SPECIFIKE TË KPK-së, (për periudhën e konkrete të shenjuar të raportimit)

1	Kërkesa për plotësimin e pozitave për prokuror në Departamenti ne Përgjithshëm
2	Kërkesa për plotësimin e pozitave për bashkëpunëtor profesional
3	
4	
5	
6	
7	
8	

V. ASPEKTE ADMINISTRATIVE:

Raportimi	Periudha kohore për të cilën raportohet	Shenjëzimi
I parë:	Nga 1 janar deri më 31 mars të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I dytë:	Nga 1 prill deri më 30 qershor të çdo viti	<input type="checkbox"/>
I tretë:	Nga 1 korrik deri më 30 shtator të çdo viti	<input checked="" type="checkbox"/>
I katërt:	Nga 1 tetor deri më 31 dhjetor të çdo viti	<input type="checkbox"/>

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kërkuar nga Kryeprokurori që të dorëzoj raportin:	Kryeprokurori e ka dorëzuar raportin në Këshill (para raportimit):
Me datë: 28.10.2022	Me datë: 28.10.2022

